

URDHËR
Nr. 106, datë 20.3.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”, të ndryshuar

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Rudin Baqli, për çështjet e mëposhtme:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e tij si nëpunës autorizues në funksion të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

II. Këto kompetenca ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

III. Delegimi i kompetencave, mbaron me revokimin e këtij urdhri, si dhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

IV. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, z. Rudin Baqli, si dhe administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Naureda Llagami